

MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE SI MEDIUM I VETËDIJESIMIT MBI REALITETET POLITIKE

RASTI I DIALOGUT TË BRUKSELIT




Raporti mbështetet nga UNMIK-u.
Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyron
mendimin zyrtar të UNMIK-ut.



NEW SOCIAL INITIATIVE

**MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE SI MEDIUM I
VETËDIJESIMIT MBI REALITETET POLITIKE**

RASTI I DIALOGUT TË BRUKSELIT



INICIATIVA SOCIALE E RE - NSI

**MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE SI
MEDIUM I VETËDIJESIMIT MBI
REALITETET POLITIKE - RASTI I DIALOGUT TË BRUKSELIT**

Botuesi:

Iniciativa Sociale e Re - NSI

Autor:

Dina Milovanović

Redaktor:

Jovana Radosavljević


Përkthimi dhe korrigjimi me Anglisht:

Bruno Neziraj

Paraqitjen dhe dizajnin:

Miloš Milovanović

QERSHOR, 2017





MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE SI MEDIUM I
VETËDIJESIMIT MBI REALITETET POLITIKE –

RASTI I DIALOGUT TË BRUKSELIT

Autor: Dina Milovanović


Mitrovica e Veriut, June 2017





PËRMBAJTJE

HYRJE	4
DISPOZITAT LIGJORE DHE IMPLEMENTIMI I TYRE	6
METODOLOGJIA	10
PERCEPTIMI I SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAVE PËR ROLIN DHE ANGAZHIMIN E TYRE NË DIALOGUN E BRUKSELIT	11
KONSIDERATAT PËRFUNDIMTARE	22
LITERATURE	25



HYRJE

Nëse shoqëria civile e Kosovës ka ngritur zërin për diçka lidhur me Dialogun e Brukselit, ajo ka qenë lidhur me mospërfshirjen në të. Por, çfarë përmasash arrin ky përjashtim, çka nënkupton ai në të vërtetë, dhe cilat janë pasojat e këtij përjashtimi për të gjitha palët? Çuditërisht, shoqëria civile, me gjithë vetëvlerësimin e lartë dhe vetëkënaqësinë që e manifeston, kurrë nuk ka ndodhur që të shqyrtojë kaq thellësisht veprimtarinë e vet, ndikimin dhe reputacionin që gëzon, e në bazë të së cilave do duhej që t'i ndahej një ulëse në çfarëdo tavoline biseduese, e aq më shumë në atë të Brukselit.¹ Marrë këtë parasysh, është me rëndësi të theksohet se ky punim nuk thotë se asaj nuk duhet t'i jepet një ulëse e tillë; në fakt, shoqëria civile mbi të gjitha duhet të argumentojë me vepra, e jo vetëm me narrativet aktuale se e gëzon këtë të drejtë.


Në anën tjetër, shoqëria civile deri në një masë e ka rishqyrtuar rolin dhe ndikimin e mediave të Serbisë dhe/ose Kosovës në kuptim të mbulimit të Dialogut të Brukselit, që nga kuantiteti (frekuenca,

sasia) e deri tek kualiteti (narrativi, qëndrimet partizane) i raportimit. Media, gjithashtu, ka reflektuar mbi punën dhe ndikimin e vet, duke u fokusuar para së gjithash në aftësinë e saj për të kryer punën, në kushtet e përgjithshme të punës dhe në pengesat dhe/ose ndikimet e ndryshme. Përveç kësaj, organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, siç janë Komisioni European (KE) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) kanë publikuar dokumente e artikuj, kanë organizuar një sërë aktivitete (diskutime në tryeza të rrumbullakëta, grupe fokusi, debate publike) lidhur me mediat e Kosovës.

Përderisa edhe mediat dhe shoqëria civile ndajnë përgjegjësinë e të funksionuarit për të mirën publike,² metodat dhe rezultatet e punës së tyre për të arritur këtë qëllim, dallojnë në një masë. Informimi i publikut është një e mirë e tillë, e që në të njëjtën kohë përbën edhe një të drejtë themelore të njeriut, të cilën pritet ta sigurojnë të dyja palët; ndërsa, parimet e sigurimit të tij duhet të bazohen në të njëjtat themele: "Të gjithë kanë të drejtë të shprehjes së qëndrimit dhe mendimit; kjo përfshin të drejtën për të mbajtur mendime pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, pranuar, dhe përçar informata e ide përmes çfarëdo mediumi,

¹ Fondi Kosovar për Shoqëri Civile publikon raporte mbi organizatat civile në Kosovë, të quajtur Indeksi i Shoqërisë Civile në Kosovë. Këto raporte janë të rëndësishme dhe informative, por megjithatë nuk analizojnë punën e organizatave individuale, por vetëm menaxhimin, strukturën, kapacitetet e përgjithshme dhe ndikimin e tyre.

² Ligji Nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, neni 5.1.



dhe përtej çfarëdo kufiri.”³ Megjithatë, niveli në të cilin ato e përmbushin këtë mandat varet në masë të madhe nga tri aspekte: 1) gatishmëria e tyre, 2) kapacitetet e tyre, dhe 3) qasshmëria dhe gatishmëria e palës tjetër për të bashkëpunuar dhe ofruar informata.

Ky punim përpiket të hulumtojë se deri në çfarë mase komponenti i tretë i lartpërmendur (qasshmëria dhe gatishmëria për bashkëpunim dhe ofrim informatash) ndikon në punën e mediave dhe shoqërisë civile, në kuptim të kontribuimit në procesin e Dialogut të Brukselit (përfshirë elaborimin e asaj se çfarë mund të jetë ky kontribut), monitorimit të procesit (parimisht implementimin e të arriturave) dhe informimit të publikut lidhur me këto dyja. Në këtë vijë, punimi do të paraqesë korrelacionin e këtij komponenti me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, duke qenë se fundja edhe mediat edhe shoqëria civile i shërbejnë realizimit të këtyre të drejtave dhe lirive.

³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 19, i rikonfirmuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 12.1.

DISPOZITAT LIGJORE DHE IMPLEMENTIMI I TYRE

Dokumentet zyrtare lidhur me Dialogun e Serbisë, të cilat gjenden në ueb-faqet e Zyrës për Kosovë dhe Metohi të Republikës së Serbisë, dhe të Qeverisë së Kosovës, përmendin vetëm në një pikë se “të dyja palët do të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për t’i informuar komunitetet e tyre lidhur me përmbytjen e “Marrëveshjes së Parë” dhe Planit të Zbatimit.”⁴ Kjo deklaratë mund të kuptohet lehtësisht asisoj që informimi i publikut do të varet nga vullneti dhe disponueshmëria e përfaqësuesve politikë për t’i informuar ata; në anën tjetër, institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre kanë obligim ligjor që t’u ofrojnë qytetarëve informata, dhe t’ua mundësojnë qasjen e plotë në dokumente publike.⁵ Për më tepër, ato obligohen që publikun ta njoftojnë me këtë të drejtë, dhe ta udhëzojnë atë përmes procesit të realizimit të kësaj të drejte.⁶ Dokumentet publike mund të përfshijnë, mes tjerash, të gjitha

⁴ *Plani i implementimit të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, i qasshëm në faqen:* <http://www.kim.gov.rs/p02.php> NB: I përkthyer nga serbishtja.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42; Ligji Nr. 03/L-215 për Qasjen në Dokumentet Publike

⁶ Ligji Nr. 03/L-215 për Qasjen në Dokumentet Publike, neni 19

informatat e regjistruara në çfarëdo forme, të nxjerra apo pranuar nga institucionet publike, e të cilat shërbejnë për të dëshmuar apo vërtetuar diçka, pa marrë parasysh formën apo karakteristikat e tyre. Teknikisht, kjo nënkupton që edhe një shkarravinë në letër, e bërë gjatë punës zyrtare (d.m.th. Dialogut të Brukselit) duhet të shihet nga syri publik.⁷

Problemi që vazhdon të vërehet në Kosovë ka të bëjë me hezitimin e institucioneve për të vepruar në pajtim me sundimin e ligjit dhe për ta implementuar ligjin. Një raport i OSBE-së konstatonte këtë në vitin 2014, duke thënë se “Sfida më e madhe mbetet Ligji për Qasje në Dokumente Publike, për implementimin e së cilit kanë vërejtje gazetarët, mediat dhe shoqëria civile. Prandaj është e qartë se vetë ekzistimi i ligjeve nuk i kontribuon përmirësimit të situatës në terren.”⁸ Mungesa e implementimit apo e vullnetit politik për implementim u demonstrua më së miri në një studim të kryer nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, BIRN, në vitet 2012/2013, në të cilin grupi hulumtues i parashtrroi institucioneve publike mbi 300 kërkesa për qasje në dokumente të ndryshme, përfshirë edhe ato që ndërlidheshin me Dialogun e Brukselit.

⁷ Ligji Nr. 03/L-215 për Qasjen në Dokumentet Publike, neni 3.1.3.

⁸ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Liria e Mediave dhe Siguria e Gazetarëve në Kosovë, Prishtinë, qershor 2014, f.17.

Vetëm 30% të kërkesave morën përgjigje pozitive.⁹ Në të shumtën e rasteve të pasuksesshme, nuk kishte fare informata kthyesë si përgjigje,¹⁰ duke dëshmuar qasjen që institucionet kanë ndaj ligjit. Një studim tjetër tregoi se me gjithë faktin që qasja në dokumente apo informata publike përbën sfidë, “qasja në informata që ndërliken me Marrëveshjet e Brukselit – vendimet e nxjerra si rrjedhojë e negociatave mes qeverisë së Kosovës dhe Serbisë është veçanërisht e vështirësuar. Shpesh, ekipet negociuese nga Kosova dhe Serbia japin sqarime kundërthënëse para mediave përkatëse lidhur me marrëveshjet specifike.”¹¹

Edhe pse raportet mbi Dialogun e Brukselit publikohen nga Ministria e Dialogut çdo gjashtë muaj,¹² e kjo i kontribuon transparencës, është me rëndësi të theksohet se këto raporte nuk përfshijnë domosdoshmërisht të gjitha dokumentet e nënshkruara, por analiza dhe prezantime të të njëjtave nga perspektiva e Ministrisë dhe Qeverisë

përkatëse.¹³ Mungesa e dokumenteve zyrtare dhe paraqitja e prezantimeve ‘të dorës së dytë’ mbi po këto dokumente, u jep hapësirë të dyja palëve të krijojnë narrativet e dëshiruara, gjë që të dyja palët e bëjnë rëndom; dhe t’i shfrytëzojnë ato narrative për dobi të tyre. Arsyeja për këtë është (jo)popullariteti i këtij procesi në Serbi dhe Kosovë: “Edhe pse nga Brukseli vazhdojnë të jepen lëvdata, politikanët që kanë negociuar në të dyja palët janë kritikuar nga popullata e tyre. Dy të tretat e serbëve nga Serbia përkrahin Dialogun me Kosovën, ndërsa një të gjë të tillë e bëjnë vetëm gjysma e shqiptarëve të Kosovës, ndërsa vetëm 10 për qind të serbëve të Kosovës nga komunat e veriut mendojnë se Kosova është duke shkuar në drejtim të duhur (në anën tjetër njëjtë mendojnë 24 për qind të shqiptarëve të Kosovës). Serbia është kritikuar nga nacionalistët se po e njeh shtetësinë e Kosovës, ndërsa ish-zëvendës kryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, dhe qeveria të cilën ajo e përfaqëson janë akuzuar për cementim të statusit të getos për Kosovën ndërsa Serbisë po i hapet rruga drejt Evropës.”¹⁴ Prandaj, të dyja palët kanë çfarë të humbasin – nga njëra anë ato duhet të vazhdojnë procesin për të përmbushur

⁹ Musliu Gresa, Shteti 30% i qasshëm për qytetarët, BIRN, Prishtinë, 2013, f. 22.

¹⁰ Po aty, 25

¹¹ IREX, Indeksi i Qendërueshmërisë së Mediave 2017: *Zhvillimi i Mediave të Qëndrueshme të Pavarura në Evropë dhe Euroazi*, Uashington DC, 2017, f. 56

¹² Zyra për Kosovë dhe Metohi e Republikës së Serbisë gjithashtu publikon raporte vjetore të progresit në procesin e Dialogut. Ato mund të gjenden në faqen në internet: <http://www.kim.gov.rs/izvestaji.php>

¹³ Raportet mund të gjenden online në faqen e Qeverisë së Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2.5>

¹⁴ BIRN, *Big Deal: Monotonia e civilizuar?, Mbikëqyrja qytetare e implementimit të marrëveshjes Kosovë - Serbi*, Prishtinë, nëntor 2014, f. 13

atë që pritet prej tyre nga Bashkimi European, ngase nga kjo varet anëtarësimi i tyre në BE, ndërsa në anën tjetër, ato duhet të luftojnë me opinionin publik dhe kundërshtimet në shtëpi.¹⁵ Një hulumtim ka treguar se një përqindje e madhe e qytetarëve konsiderojnë që përfaqësuesit politikë nuk janë duke i informuar ata në mënyrë adekuate lidhur me marrëveshjet dhe implementimin e tyre. Për shembull, 93% të qytetarëve mendojnë se nuk i kanë të gjitha informatat lidhur me procesin e integritetit të sistemit të drejtësisë së Republikës së Serbisë, në sistemin e drejtësisë të Qeverisë së Kosovës, ndërsa 55% të tyre nuk e përkrahin integritetin fare.¹⁶ Marrë këtë parasysh, nuk është vështirë të kuptohet përse “shumëkuptueshmëria e aplikuar gjatë negociatave ka qenë kyçe për arritjen e marrëveshjes (...)”¹⁷

¹⁵ Një tjetër raport vërente se: “Dialogu është duke humbur në popullaritet, veçanërisht në Kosovë ku partitë opozitare janë duke e kundërshtuar fuqishëm formimin e Asociacionit/Komunitetit dhe e kanë hapur një krizë politike atje.” Qendra për Qeverisje Përfshirëse, Dialogu i Brukselit: hapat vijues dhe sfidat para tij, nëntor 2015, në faqen: <http://www.cigonline.net/docs/Brussels%20Dialogue%20Next%20Steps%20and%20Challenges%20Ahead.pdf>

¹⁶ ACDC, Kontakt Plus, *Pasojat e shtyerjes së integritetit të sistemit të drejtësisë: Gjendja dhe perspektivat*, Mitrovicë, maj 2015, f. 8

¹⁷ Neshoviq, Branislav, Celeghini, Riccardo, *Komuniteti/Asociacioni i Komunave të Serbisë: Përmbledhje e frikave më të mëdha*, NGO AKTIV, Mitrovicë, qershor 2015, f. I

Në anën tjetër, është me rëndësi të theksohet se Ligji për Qasje në Dokumente Publike si i tillë nuk kërkon që dokumentet të bëhen publike para paraqitjes së kërkesës zyrtare, dhe kjo mangësi i jep mundësi Qeverisë së Kosovës të mbajë publikun të painformuar mbi faktet. Megjithatë, ekzistojnë rregullore të cilat, deri në një masë, i obligojnë institucionet qeveritare që të kryejnë konsultime publike gjatë përkufizimit, hartimit dhe implementimit të legjislacionit dhe politikave.¹⁸ Marrë parasysh se marrëveshjet e arritura në Bruksel duhet të implementohen në Kosovë sipas kornizës ligjore të Kosovës, nuk do të ishte befasisëse që edhe ato t'i nënshtrohen rregullave dhe rregulloreve të njëjta. Megjithatë, duket se vullneti politik për zbatim dhe sundim të ligjit mungon edhe në këtë rast. Raporti i Progresit të Kosovës (2016) i Bashkimit European vëren se “Progresi është arritur me miratimin e standardeve minimale të konsultimit publik në muajin prill, të cilat janë dizajnuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Mungesa e angazhimit të shumë ministrive, dhe pamjaftueshmëria e kapaciteteve dhe mjeteve buxhetore, kanë dëmtuar përpjekjet për të implementuar strategjinë për bashkëpunimin me shoqërinë civile, gjë që rezulton me dyshime për mungesën e

¹⁸ Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik

vullnetit politik për të bërë këtë.”¹⁹ Studimi i kryer nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), në vitin 2015, zbulonte se: “Përderisa korniza ligjore ofron mundësinë e zhvillimit të një procesi të hapur të vendimmarrjes, implementimi i legjislacionit ka ngecje. Sipas Indeksit të Shoqërisë Civile në Kosovë, 64% të OShC-ve kanë deklaruar se kanë qenë të përfshira në procese politikëbërëse gjatë tri viteve të fundit. Megjithatë, vetëm 29.29% të OShC-ve kanë deklaruar se janë ftuar rregullisht për konsultime për ligje/politika relevante për punën e tyre.”²⁰ Gjithashtu, edhe kur zhvillohen konsultimet, ato zakonisht mbesin vështirë për t’u përshtatur - me mungesë të informatave të rëndësishme, kërkim të përgjigjeve në afate të shkurtra, me ofrim të fare pak (ose aspak) njoftimeve lidhur me procesin. Më e rëndësishmja është “sfida specifike që ndërlidhet me mungesën e informatave, dhe konsultimeve publike për ligje që konsiderohen me interes të lartë politik apo ekonomik.”²¹

Marrë parasysh të gjitha që u thanë më sipër, parashtrohet pyetja nëse shoqëria civile dhe mediat kanë mundësi të

ushtrojnë të drejtat e tyre kushtetuese – të kryejnë hulumtimet, analizojnë informatat, dhe ta ekspozojnë qytetarin tek faktet dhe të gjeturat; si dhe të asistojnë dhe avokojnë për zhvillimin e një kornize progresive, demokratike dhe përfshirëse ligjore dhe implementimin e saj. Për më tepër, parashtrohet pyetja nëse qytetarët janë të aftë ta ushtrojnë lirinë e vet, dhe të marrin informata e shprehin qëndrime në bazë të informatave. Nën këtë prizëm, punimi në vijim do të përpiket ta qartësojë këtë korrelacion, duke shqyrtuar përfshirjen e shoqërisë civile dhe mediave në Dialogun e Brukselit.

¹⁹ Bashkimi Evropian: Komisioni Evropian, *Raporti i vitit 2016 për Kosovë**, Bruksel, 9 nëntor 2016, SWD (2016) 363, f. 9

²⁰ Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile, *Zinxhiri i Pakompletuar - Propozim i Politikave mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik*, janar 2015, f. 11

²¹ Po aty.

METODOLOGJIA

Ky punim është produkt i një hulumtimi të kryer për Projektin “Rritja e kapaciteteve dhe besueshmërisë së OJQ-ve dhe mediave shqiptare dhe serbe në Kosovë”, implementuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, BIRN, si dhe Iniciativa e Re Shoqërore (NSI), mbështetur nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Hulumtimi bazohet në studime kualitative në zyrë dhe terren, kryer në periudhën mes marsit 2017 deri në maj 2017. Hulumtimi është kryer nga ekipi hulumtues i NSI-së, me mbështetjen e partnerit implementues të projektit.

Hulumtimi në zyrë ka përfshirë grumbullimin, shqyrtimin dhe analizimin e të dhënave të shkruara, duke përfshirë: dokumentet e miratuara në Bruksel; kornizat ligjore shtetërore në lidhje me qasjen në informata, konsultimet publike, shoqëria civile, mediat; raportet, dokumentet hulumtuese, dokumentet e politikave të institucioneve publike, organizatave ndërkombëtare, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave, për dispozitat ligjore dhe zbatimin e tyre (në lidhje me temën e hulumtimit), si dhe rolin dhe angazhimin e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave në Dialogun e Brukselit. Afërsisht 2/3 e të dhënave me shkrim janë grumbulluar, si dhe pas leximit

fillestar, janë përdorur për këtë hulumtim.

Hulumtimi në terren ka përfshirë 3 tryeza të rrumbullakëta të organizuara në Mitrovicë të veriut, Leposaviq dhe Prishtinë. Tryezat e rrumbullakëta përfshinin përfaqësues të mediave dhe organizatave të shoqërisë civile nga Kosova, nga komuniteti shumicë dhe ata jo-shumicë. Temat e tryezave të rrumbullakëta përfshinin: kapacitetet, angazhimin, ndikimin dhe punën në përgjithësi të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave serbe dhe shqiptare në Kosovë, në lidhje me Dialogun e Brukselit. Përveç këtyre, ekipi hulumtues ka kryer 10 intervista me përfaqësues të shoqërisë civile (5 përfaqësues të shoqërisë civile serbe të Kosovës dhe pesë nga shoqëria civile shqiptare) si dhe 10 intervista me përfaqësues të mediave (5 nga mediat serbe, 5 nga mediat shqipe në Kosovë). Temat e trajtuara në intervista kanë qenë: Puna e tyre në lidhje me Dialogun e Brukselit, familjarizimi dhe përfshirja në Dialogun e Brukselit, si dhe qasja në informata, si dhe përfaqësuesit politikë. Të gjithë të intervistuarit janë zgjedhur në bazë të afërsisë së tyre me temat e hulumtimit, punës së tyre dhe reputacionit. Për të ruajtur konfidencialitetin e identiteteve të tyre, kemi përdorur vetëm tri kriterë për identifikimin e tyre: kategoria e përgjigjeve (intervistë apo tryezë), gjinia (mashkull, femër, tjetër), fusha e punës (shoqëri civile, media).

PERCEPTIMI I SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAVE PËR ROLIN DHE ANGAZHIMIN E TYRE NË DIALOGUN E BRUKSELIT

Gjatë kryerjes së punës në terren, ekipi hulumtues është fokusuar tek hulumtimi i disa temave në lidhje me pyetjet e hulumtimit; këto tema janë: 1) qasja në informata dhe dokumente publike; 2) qasshmëria e përfaqësuesve politikë; 3) roli i mediave; 4) roli i shoqërisë civile. Përmes këtyre temave, jemi përpjekur të krijojmë një “pamje më të gjerë” të të gjithë situatës, roleve të ndryshme të aktorëve të ndryshëm, pasojat ekzistuese si dhe gjasat për përmirësim të gjendjes në përgjithësi.

QASJA NË INFORMATA DHE DOKUMENTE PUBLIKE

Të gjithë të intervistuarit janë pyetur se si informohen, dhe çfarë qasje kanë në dokumente e informata zyrtare në lidhje me Dialogun e Brukselit. Më interesante është që respondentët kanë ndërlidhur qasjen në informata me përfaqësuesit politikë të të tri palëve (Qeveria e Serbisë, Qeveria e Kosovës, Bashkimi European). Ndërlidhja mund të mos jetë befasuese, pasi që përfaqësuesit politikë duhet të japin deklarata dhe të bisedojnë me mediat, por, çështja është kur ato deklarata dallojnë shumë, në mungesë të ndonjë vërtetimi, përveç fjalës së thënë. “Me informatat që mbeten të

centralizuara dhe të fshehura nga syri i publikut, vakumi i informatave hap derën për interpretime të ndryshme të ngjarjes së njëjtë dhe marrëveshjeve të arritura. Liderët politikë janë porta e informatave për Dialogun, derisa mediat luftojnë për të shkuar pak më tutje sesa thjesht riprodhimi i deklaratave zyrtare në raportim për procesin.”²²

“Informatat zakonisht vinë përmes mediave. Gjithashtu përpiqem të takohem me kontaktet e mia personale me organizatat ndërkombëtare dhe vendim-marrësit në Beograd dhe Prishtinë.”
Intervistë, Burrë, Shoqëri civile

“I gjithë Dialogu i Brukselit përfundon me komunikimin e drejtuar kah BE-ja, derisa ne (mediat) marrim informata krejtësisht të kundërta nga palët e përfshira. Për atë arsye, është tejet e vështirë për ne të kontrollojmë informatat e dhëna nga përfaqësuesit politikë. Në këtë kuptim, po humbim mundësinë që të bëjmë kontrollimin e fakteve në lidhje me fjalën e thënë, pasi që si raportues nuk duhet të bazohemi

²² Garaiova Andrea, Mbulimi mediatik i Dialogut të Brukselit dhe perspektiva e pajtimit në Kosovë (*Brussels Dialog Media Coverage and Reconciliation Prospects in Kosovo*), Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, Prishtinë, 2017 (drafti final), f. 12

vetëm tek burimet politike, kushdo qofshin ato.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

“Nëse flasim për Dialogun e Brukselit, është procesi më së paku transparent. Ka një numër arsyes për këtë, por ajo që duket është fakti që në secilin raund të takimeve, dy anët japin deklarata kundërthënëse për atë që është dakorduar. Ata e bëjnë për përfitim të poenave politikë. Gazetarët nuk janë në gjendje të gjejnë të vërtetën, sepse vetëm tash, ca muaj më vonë, kemi në letër dëshminë për atë që është folur.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

Mungesa e qasjes në dokumente publike, apo vonesa e publikimit, siç theksohet nga respondentët, ndikojnë jo vetëm në mundësinë e të informuarit dhe informimit të qytetarit, por edhe për të kryer punën në mënyrë profesionale dhe të plotë. Kjo është posaçërisht e dukshme në rastin e dokumenteve të ndërlidhura me Dialogun e Brukselit, pasi që “qasja në informata është veçanërisht e kufizuar tek Marrëveshjet e Brukselit – vendimet e marra në negociatat ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Shumë shpesh, ekipet negociuese nga Kosova dhe Serbia japin shpjegime

kundërthënëse për mediat përkatëse në lidhje me marrëveshjet e caktuara.”²³

“Pas çdo raundi të negociimit, gazetarët kërkojnë nga zyrtarët të kenë qasje në dokumente. Fatkeqësisht, marrja e dokumenteve nuk ka qenë e mundur për shumicën e mediave. Gjithashtu, kemi përdorur ligjin për qasje në dokumente publike, por as kjo vegël nuk na ka ndihmuar. Pas presionit të rritur, ekipi negociues i Kosovës u përpoq të publikonte dokumentet e marrëveshjes. Por, edhe në këtë rast, ata shfrytëzuan mediat në të cilat kanë ndikim. Kjo është një lloj taktike për t'i dhënë orientim asaj marrëveshjeje. Redaksitë tjera duheshin të përdornin përmbajtjen nga këto medime, sepse nuk mund t'i siguronin vetë dokumentet. Në këtë rast, ka hapësira për keqinformim.”

Intervistë, Burrë, Media

“Dialogu nuk është fort transparent, pasi që nuk kemi pasur qasje në bisedimet e nivelit të lartë para se Dialogu të ndërpritej nga Kuvendi i Kosovës. Pasi kemi insistuar, pasi kemi lobuar, kemi filluar të marrim marrëveshjet në internet. Pa marrë

²³ IREX, Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave 2017: Zhvillimi i mediave të pavarura e të qëndrueshme në Evropë dhe Eurazi (*Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia*), Uashington DC, 2017, f. 56

parasysh qeverinë që dëgjon, nuk mund të kesh qasje të drejtpërdrejtë në materialet që janë nënshkruar. Shumica e materialeve tashmë janë aty.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

Korniza ligjore për qasje në dokumente publike duket të ketë mangësi në zbatim në këtë rast, ose përmes mungesës së përgjegjshmërisë së institucioneve përkatëse, ose përmes gjetjes së mundësive të shmangies së ligjit. Gjë e ngjashme është vërejtur nga OSBE-ja, më 2014, në raportin e lirisë së mediave në Kosovë: “Sfida kryesore mbetet tek Ligji për qasje në dokumente publike, ku gazetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile pohojnë të ketë mangësi në zbatim. Pra, është e qartë që thjeshtë ekzistenca e ligjeve nuk kontribuon në ndonjë përmirësim në terren.”²⁴

Respondentët tanë thonë që, tri vite më vonë, situata nuk është përmirësuar shumë.

“Marrëveshjet prezantohen si dokumente ndërkombëtare, si dhe si të tilla, lejohen të jenë sekrete.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

²⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë (*Freedom of Media and Safety of Journalists in Kosovo*), Prishtinë, qershor 2014, f. 17

“Gjithmonë dërgojmë mbi 10 e-mail-a për të marrë ndonjë informatë apo dokument.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

Edhe kur dokumentet vihen në dispozicion, dalin probleme të tjera.

“Ka gjëra që nuk janë në përputhje me dokumentacionin në dispozicion, por gjendja e përgjithshme është shumë më e mirë sot. Ka dokumente në dispozicion në faqet e internetit të të dy qeverive. Ka shumë informata që mund të gjenden dhe qasen, por nëse ka ndonjë keqkuptim, është shumë vështirë të gjenden informata mbi interpretimin që është i sakti.”

Intervistë, Grua, Media

“Dokumentet kryesore janë në faqet e institucioneve; pra, janë në dispozicion të publikut. Megjithatë, çështje tjetër janë pasojat e Dialogut të Brukselit, si investimet në veri, që nuk janë lehtësisht të qasshme. Personalisht jam përpjekur të thirrem tek Ligji për qasje në dokumente publike kur kërkoja informata, por pa sukses. Situata ndërlikohet edhe më shumë kur marrim parasysh faktin që komunikimi me institucionet publike duhet të jetë në përputhje

me ligjet tjera, kryesisht grupin e ligjeve që kanë të bëjnë me gjuhët dhe përdorimin e tyre zyrtar. Çdo korrespondencë me institucionet publike në gjuhën serbe apo angleze është e ngarkuar si e tillë.”

Intervistë, Grua, Media

QASSHMËRIA E PËRFAQËSUESVE POLITIKË

Duke pasur parasysh që përfaqësuesit politikë nuk konsiderohen sinonim i qasjes në informata, qasja tek ata ka vlerë të njëjtë, apo edhe më të vogël, si pasojë e mungesës së burimeve të tjera. Shumica e respondentëve pajtohen që përfaqësuesit politikë janë përgjithësisht të disponueshëm për deklarata në konferenca shtypi pas ngjarjeve të rëndësishme. Megjithatë, problemi fillon kur ata ftohen të flasin individualisht për një medium të caktuar apo gazetar; këtu vjen në pah preferenca politike apo personale në kuptimin e ftesave që mbesin të paarsyetuara.

“Një prej sfidave të mëdha është kur tek implementimi i projektit ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave – është vërtetuar të jetë sfiduese të gjenden të intervistuarit e duhur politikë në të dyja anët, gjë që përfundimisht reflekton mbi cilësinë e informatave dhe punën tonë.”

Intervistë, Burrë, Shoqëri civile

“Në bazë të praktikës, liderët apo kryenegociatorët nuk përgjigjen në pyetje të gazetarit, gjë që rrit mundësinë e keqinformimit, pasi që gazetarët pastaj duhet të kërkojnë burime të tjera jozyrtare që shpesh nuk janë shumë të besueshëm.”

Intervistë, Burrë, Media

“Gjithashtu, një prej gjërave që ndikojnë në mungesë të transparencës është përzgjedhja e mediave. Politikanët zgjedhin mediat me të cilat duan të flasin për Dialogun e Brukselit. Besimi im është që bisedat e përfaqësuesve të të dyja anëve me mediat ka qenë e parapërgatitur, jo vetëm me mediat, por edhe ndërmjet tyre.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

“Pala serbe flet vetëm për mediat serbe, derisa pala kosovare flet vetëm për mediat në gjuhën shqipe. Mediat serbe nuk lejohen të bëjnë pyetje për përfaqësuesit e Kosovës, derisa mediat në gjuhën shqipe nuk lejohen të bëjnë pyetje për përfaqësuesit e Serbisë.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

Interesante është që këto sjellje të përfaqësuesve politikë janë ngushtë të ndërlidhura me vetë mediat, duke krijuar perceptimin për disa media si politikisht të anshme. “(...) mediat mund të

kontribuojnë në polarizimin e publikut, si dhe përfundimisht drejt rezultateve destruktive e konfliktuozë. Kjo jep tokën pjellore për një qark vicioz të polarizimit; nëse raportimi ushqen polarizimin ndërmjet komuniteteve, ai inkurajon përfaqësuesit politikë të vazhdojnë me retorikën polarizuese, pasi përpiqen t'i përgjigjen disponimit të publikut për arsye të përfitimit politik. Kjo pastaj e gjen rrugën drejt lajmeve në media, që përfundimisht prapë nxitet për shkak të mungesës së përgjithshme të informatave, si dhe mbështetja e mediave tek deklaratat zyrtare në lidhje me Dialogun e Brukselit.”²⁵

Një arsye tjetër për situatën e tillë është fakti që politikanët lokalë në Kosovë, që janë në dispozicion të gazetarëve, ngurrojnë të flasin për Dialogun, apo edhe vetë nuk janë të informuar për procesin. Së voni, Zv/Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në një emision, kishte thënë që “(...) ndoshta nuk e di se çfarë shkruhet në marrëveshjet e Brukselit, si të tjerët që jemi këtu. Ne tek Lista Srpska nuk dimë shumë më shumë sesa publiku, apo çdo qytetar.”²⁶

²⁵ Garaiova Andrea, Mbulimi mediatik i Dialogut të Brukselit dhe perspektiva e pajtimit në Kosovë (*Brussels Dialog Media Coverage and Reconciliation Prospects in Kosovo*), Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, Prishtinë, 2017 (drafti final), f. 13

²⁶ KoSSev, *Jevtićeva: Srpska na pragu rascepa, veliki deo odgovornosti snosi Kancelarija za KiM*, 1 maj, 2017, gjendet tek:

Ngjashëm është theksuar nga respondentët, të cilët pajtohen që procesi është jotransparent jo vetëm për publikun, por edhe për politikanët.

“Edhe kur marrim informatën, që është mjaft e rrallë, duket që vetëm disa persona brenda procesit kanë të gjitha informatat. Kjo përfundimisht reflekton tek mundësia jonë për të marrë informatën e duhur, edhe kur kemi qasje në vendim-marrës apo politikanë të duhur. Vetëm ata që kanë qasje tek njerëzit e duhur kanë informatat e duhura.”

Intervistë, Burrë, Shoqëri civile

“Serbët e Kosovës janë përjashtuar nga procesi, e për më tepër, janë të painformuar, edhe pse janë më të ndikuarit nga ai.”

Intervistë, Burrë, Shoqëri civile

ROLI I MEDIAVE

Hulumtimet kanë treguar se për dialogun e Brukselit dhe zbatimin e marrëveshjeve, qytetarët kryesisht informohen përmes raportimeve në media²⁷. Për më tepër, “ajo që është e

http://kossev.info/strana/arhiva/jevtic_ss/11801

²⁷ Hulumtimi i kryer nga ACDC dhe Kontakt Plus tregon që 63% e qytetarëve informohen për integrimin e sistemit të drejtësisë përmes mediave. Për më shumë, shih: ACDC, Kontakt Plus,

dukshme është se temat më së shumti të debatuar në publik dhe media janë ato për të cilat qytetarët kanë më së shumti informacion. Në anën tjetër, marrëveshjet të cilat nuk kanë qenë aq të pranishme në media, janë ato për të cilat qytetarët kanë më pak informacion.”²⁸ Kështu, roli dhe ndikimi i mediave në publik, në kuptim të vetëdijesimit lidhur me realitetet politike, ekziston, por pyetja që paraqitet është vetë-perceptimi i tyre lidhur me punën që kryejnë dhe përgjegjësitë që kanë.

Është interesante që të anketuarit nga mediat ishin shumë kritikë për rolin dhe ndikimin e tyre, duke kuptuar rezultatet e punës së tyre në drejtim të formimit të diskursit publik. Fakti që ata gëzojnë admirimin dhe popullaritetin e qytetarëve në një nivel të caktuar, bën që përgjegjësia e tyre ndaj qytetarëve të jetë edhe më e madhe. Besueshmëria ishte fjala më e përdorur për t’ju referuar veprimeve të gabuara/të drejta të gazetarëve, redaktimit dhe menaxhimit.

Posledice odlaganja integracije pravosuđa: Stanje i perspektive, Mitrović, Maj, 2015, f. 8

²⁸ Demokratski Insitut Kosova, *Transparentnost Dijaloga Kosova i Srbije: Gledišta gradjana*, September, 2016, p. 4 NB: përkthyer nga serbishtja.

“Duhet të flasim për besueshmërinë e gazetarëve. Gjatë dy muajve të fundit kemi vërejtur një rritje të gjuhës së urrejtjes në raportim, kryesisht të drejtuar karshi grupeve të caktuara etnike apo fetare.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

“Në kuptim të besueshmërisë së mediave, mund të theksojmë që kemi një krizë, dhe jo vetëm të përkohshme, por të vërtetë, serioze. Kriza mbi të gjitha shihet në raportimin me paragjykim për të dyja komunitetet, gjuhën e papërshtatshme dhe thirrjet për ndarje më të thella. Ne, si komunitete, nuk e kemi arritur pikën e tejkalimit të tërë kësaj, por unë besoj se me përpjekje dhe bashkëpunim të mëtejshëm mund ta përmirësojmë këtë situatë.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

“Ne nuk kemi zgjidhje për mediat. Është një numër i vogël i mediave cilësore të pavarura. Publiku nuk do ta gjejë të vërtetën nga mediat. Gazetari nuk do ta ketë të drejtën të thotë atë duhet të thuhet. Unë nuk shoh të ardhme të ndritshme për mediat.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

Gjithashtu, ata ishin të zëshëm lidhur me kufizimet e tyre të kapaciteteve, njohurive dhe burimeve kur mbulonin tema të ndjeshme publike si marrëdhëniet rajonale, Dialogu i Brukselit apo edhe çështjet e brendshme. Këto kufizime përfundimisht ndikojnë në punën e tyre të përgjithshme dhe mundësinë për t'i shtruar si informata të rëndësishme për publikun. E njëjta është vërejtur edhe në një studim të kryer nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, KCSF, i realizuar në vitin 2016: "Mediat përballen me vështirësi të veçantë për t'i sjellë madje edhe informatat bazike për publikun dhe nuk janë në gjendje të ushtrojnë plotësisht funksionin e tyre të verifikimit të fakteve. Siç është demonstruar me njërën prej marrëveshjeve të fundit, marrëveshja për kodin ndërkombëtar të thirrjeve për Kosovën, zyrtarët nuk hezitojnë të deklarojnë se nënshkrimi ishte i suksesshëm pa publikuar fare përmbajtjen e marrëveshjes tek mediat për raportim dhe për publikun, për javë të tëra. Kështu, mediat mbesin në terr informativ, duke u përpjekur t'i publikojnë ato informata të pakta që mund t'i gjejnë."²⁹

²⁹ Garaiova Andrea, Mbulimi mediatik i Dialogut të Brukselit dhe perspektiva e pajtimit në Kosovë (*Brussels Dialog Media Coverage and Reconciliation Prospects in Kosovo*), Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, Prishtinë, 2017 (drafti final), f. 14

"Mediat në Kosovë kanë përmbushur rolin e tyre primar i cili është informimi. Problemi është se nuk asgjë mbi këtë. Nuk ka fare hulumtim në gazetari."

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

"Vetë mediave u mungojnë kapacitetet për të mbuluar çdo gjë që ndodhë në Bruksel gjatë bisedimeve në kuadër të Dialogut, dhe për t'i prezantuar ato në publik në mënyrë të drejtë."

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

"Besoj që ka lidhje të qartë ndërmjet kapaciteteve të mediave në raportim, dhe kredibilitetit të tyre. Çështja më kryesore me të cilën përballen mediat është mungesa e kapaciteteve, gazetarëve, dhe ajo e redaksive përkatëse."

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

Një prej kufizimeve të qarta është ndarja e mediave në bazë të komuniteteve të cilave i raportojnë, gjuhës të cilën e flasin/përdorin, si dhe komunikimit të cilin e kanë me njëra-tjetrën.

"Ajo që është gjithashtu problem në lidhje me mediat është ndarja në media shqipe dhe serbe. Edhe pse

përpiqemi të jemi të paanshëm,
kemi audienca të ndryshme dhe
priremi të harrojmë palën tjetër,
duke na bërë të pavetëdijshëm për
përgjegjësinë që kemi në këtë
proces.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

“Gjithashtu, nuk e kuptojmë njëri-
tjetrin, nuk flasim gjuhët e njëri-
tjetrit, gjë që na pengon në ndarjen
e informatave.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

Fakti që përfaqësuesit e mediave janë të
aftë të vetë-reflektojnë nuk do të thotë që
puna dhe kontributi i tyre nuk duhet
vërejtur e çmuar. Siç është thënë më lart,
ata janë mekanizmi të cilit i drejtohen
 shumica e qytetarëve, kur duan të
informohen për Dialogun e Brukselit apo
zbatimin e tij; kjo dëshmon qasshmërinë
e tyre, por edhe reputacionin dhe
ndikimin. Përfundimisht, nëse nuk do të
besonin në vete dhe punën e tyre, nuk do
të ishin aty ku janë sot – duke luftuar për
profesionin e tyre, imazhin dhe të
ardhmen e tyre.

“Nuk është vetëm informimi i
publikut. Nganjëherë është me
rëndësi të dihet se (si) të mos
informohet për diçka.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

“Kemi media të pavarura në
Kosovë. Nuk mund të presim nga të
gjitha mediat të jenë të pavarura,
por mund të përpiqemi të ofrojmë
kontributin tonë në atë drejtim.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

“Mediat kanë rol tejet të
rëndësishëm në procesin e
Dialogut. Roli më i rëndësishëm
ishte fakti që mediat kanë qenë i
vetmi burim i informimit për njerëz
që janë të interesuar të informohen
për marrëveshjet.”

Intervistë, Burrë, Media

“Roli i mediave dhe shoqërisë civile
duket të jetë me rëndësi të madhe,
pasi që perceptohen si më të afërtat
për të kuptuar Dialogun e Brukselit
dhe për ta shpjeguar për qytetarë.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Media*

ROLI I SHOQËRISË CIVILE

Shoqëria civile ka qenë më e zëshmjë për
përfundimin e saj nga Dialogu i Brukselit,
si dhe pasojat që ky vendim bartë.
Megjithatë, kjo nuk i ka shoqërisë civile
për të marrur pjesë në mënyrë aktive në
vëzhgim të Dialogut përgjatë gjithë
procesit. Numri i organizatave të
shoqërisë civile të fokusuar tek
hulumtimi, kuptimi dhe prezantimi i
marrëveshjeve, në kuptimin e
implikimeve politike dhe teknike që ato

sjellin.³⁰ Ato, gjithashtu, kanë qenë mjaft të zëshme në lidhje me rëndësinë e kuptimit dhe përfshirjes së qëndrimeve, dhe botëkuptimeve të qytetarëve për procesin, pasi që janë ata që e bartin barrën ps përfundimit të këtij procesi.. Për këtë arsye, ata besojnë që vetë, përmes punës dhe ndikimit të tyre, meritojnë ulëse në tavolinë – pasi që mund të mos jenë votuar/zgjedhur si përfaqësues të qytetarëve, por gjithsesi i njohin qytetarët më së miri.

Respondentët kanë folur për atë që ka mundur të bëhet ndryshe, si dhe çfarë rolesh do të mund të kishin ata. Ata e kuptojnë arsyen për përjashtimin e tyre, por edhe pasojat nga kjo. Mungesa e tyre në diskursin politik është vërejtur edhe tek Raporti i Progresit të BE-së, që thekson: “Mungesa e vullnetit politik do të thotë se pjesëmarrja e shoqërisë civile në politikë-bërje mbetet e pabarabartë. (...) Mungesa e angazhimit nga shumë ministri si dhe kapaciteti e resurset buxhetore të pamjaftueshme kanë penguar përpjekjet për zbatim të strategjisë për bashkëpunim me shoqëri civile dhe vazhdon të hedhë dyshim mbi vullnetin politik në prapavijë.”³¹

³⁰ Një pjesë e punës së tillë është përdorur edhe për këtë punim. Megjithatë, kjo është vetëm një pjesë e punëve të mëdha që organizatat e shoqërisë civile nga komuniteti shqiptar dhe ai serb kanë kryer në vitet e kaluara, në kuptimin e hulumtimit dhe botimit për Dialogun në Bruksel.

³¹ Bashkimi Evropian: Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën* 2016 (European Union: European Commission, *Kosovo* 2016 Report*),

“Negociatorët kanë diskutuar disa gjëra me neve, por ajo që ka qenë e dukshme në lidhje me të gjithë komunikimin ka qenë fakti që është udhëhequr vetëm nga veprimtaria e OJQ-ve, pasi që ata (negociatorët) asnjëherë nuk na kanë ftuar, të na kërkonin më shumë informata, apo të pajtoheshin për të ndarë informata me qytetarët.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Shoqëri civile*

“Angazhimi i shoqërisë civile nuk ka qenë adekuat, pasi që ne do të mund të kontribuonim në proces, kryesisht në kuptimin e informimit të qytetarëve dhe lehtësimin e gjërave që janë më të vështira të implementohen. Shoqëria civile mund të krijojë diskutimin publik për dialogun, por asnjëherë nuk na kanë thirrur të bëjmë ashtu.”

Intervistë, Burrë, Shoqëri civile

“Angazhimi jonë (i shoqërisë civile) në marrëveshje është në nivel të zbatimit – niveli më i rëndësishëm, që është diskutuar vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjeve. Kështu, nuk kemi arritur të ndikojmë në marrëveshje para miratimit të tyre. Problemi lind pasi që njerëzit që kanë negociuar nuk

Bruksel, 9 nëntor 2016, SVVD (2016) 363 final, faqe 9

kanë qenë të informuar për gjendjen në terren, për të cilën zbatimi është vërtetuar të jetë problematik. Në anën e kundërt, ka aq shumë probleme praktike që do të mund të zgjidheshin lehtë, por që kanë gjithsesi rëndësi, pasi që pa to marrëveshjet nuk mund të zbatohen me sukses.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Grua, Shoqëri civile*

Në anën tjetër, respondentët kanë folur edhe për përgjegjësinë e tyre, pra të shoqërisë civile, për gjendjen aktuale, pasi që duhen dy veta për vallëzim. Vetë-reflektimi dhe kritikën nuk largohen as nga puna e kryer nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe respondentët kanë shfaqur vetëdijen e tyre për punën destruktive nga vetë sektori që ata përfaqësojnë. Pyetjet kryesore kishin të bënin me apolitizimin e shoqërisë civile, afërsinë e tyre politike, si dhe qëndrimin e tyre të përgjithshëm në lidhje me Dialogun e Brukselit si dhe rëndësinë e tij për shoqërinë e Kosovës.

“Nuk besoj që ka problem tek shoqëria civile. Gjithmonë ka teori konspiracioni për shoqërinë civile në Kosovë, si dhe zakonisht lidhet me politikën; problemi është që disa prej këtyre teorive janë dëshmuar si të vërteta. Për shembull, së voni kemi një raport për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile –

kemi pasur informata njëllojëse, që na bëjnë të gjithëve të pyetemi nëse shoqëria civile është e paanshme dhe nëse meriton të ketë rol të rëndësishëm brenda dialogut.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

“Ne priremi të dëgjojmë atë që negociatorët na thonë. Por ata janë politikanë, ndërsa ajo që na duhet neve nën syrin e publikut është një zë neutral; mu këtu duhet të hyjë shoqëria civile. Por problemi është që edhe shoqëria civile në një mënyrë a tjetër është politizuar.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Shoqëri civile*

“Brukseli nuk përfshin OJQ-të sepse OJQ-të janë kundër këtij procesi. Shumica e organizatave në Kosovë dhe Serbi janë më patriotike sesa vetë qeveritë.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Shoqëri civile*

Në të kundërtën me pikat e sipërme, roli dhe ndikimi i shoqërisë civile nuk duhet nënvlerësuar. Respondentët kanë vërejtur që bashkë me mediat, shoqëria civile është e vetmja me kapacitetet për të analizuar gjendjen e përgjithshme politike dhe sociale dhe për ta komunikuar tek qytetarët. Siç theksohet më lart, puna e tyre dhe paraqitja publike, në vitet e fundit, ka pasur shumë fokus mbi Dialogun e Brukselit, pa marrë

parasysh përjashtimin e tyre nga ai. Megjithatë, ndikimi i tyre ende nuk është aq publik sa politika apo politikanët, pasi që nuk zënë aq shumë hapësirë apo kohë publike; gjë që shpesh e largon punën e tyre nga vëmendja. Kjo mund të ndryshohet me thellimin e marrëdhënieve mes institucioneve qendrore dhe shoqërisë civile, pasi “shoqëria civile e fuqizuar është komponent qenësor i sistemit demokratik dhe duhet njohur e trajtuar si i tillë nga institucionet në Kosovë. Shoqëria civile nevojitet të vazhdojë të luajë rol qenësor në debatit demokratik si dhe në pjesëmarrje në dizajnimin dhe implementimin e politikave publike.”³²

“Roli i shoqërisë civile ka rëndësi ekstreme, por ndikimi i tyre mbi ata që na drejtojnë jetën tonë është e kufizuar. Brukseli është vendim-marrësi, si dhe shoqëria civile, bashkë me mediat, duhet të shtyjnë përpara më shumë në disa çështje. Nuk duhet të harrojmë që disa prej temave të rëndësishme janë filluar nga shoqëria civile, si dhe po të mos ishin ato, mund të mos flisnim për disa çështje, ose së paku jo në publik.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

“Një numër i analizave të kryera nga shoqëria civile kanë qenë mjaft kritike ndaj Dialogut të Brukselit. Ka organizata që nuk frikësohen të bëjnë studime të politikave të ndryshme, si dhe të kërkojnë ndryshim të qasjes në zbatim të tyre, apo edhe brenda vetë politikave të tilla. Pyetja që mbetet ka të bëjë me nivelin e ndikimit që ato kanë, pasi që shpesh shohim që rekomandimet e tyre nuk merren parasysh. Megjithatë, nuk mund të thuhet që puna e tyre nuk ka vlerë, sepse nëse asgjë tjetër, shërben si udhërrëfyes për atë ku do të duhej fokusuar media më tutje. Unë besoj që nëse shoqëria civile ka rol të rëndësishëm, ky shpesh është lënë anash, për shkak të veprave të pahijshme që një numër shumë më i vogël i organizatave të shoqërisë civile kanë bërë. Nuk duhet të lejojmë që veprimet e tyre të flasin në emrin e të gjithë sektorit.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

³² Bashkimi Evropian: Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën* 2016 (European Union: European Commission, *Kosovo* 2016 Report*), Bruksel, 9 nëntor 2016, SVVD (2016) 363 final, faqe 9

KONSIDERATAT PËRFUNDIMTARE

Numri i organizatave të shoqërisë civile rritet çdo vit, por ajo që duket të jetë konstate është numri i atyre që janë aktive. Ndikimi i tyre dallon sipas lokacionit, rrjeteve formale e joformale, por edhe sipas komunitetit që përfaqësojnë dhe/ose punojnë. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur ka kryer një studim të përgjithshëm për shoqërinë civile në Kosovë, dhe ka zbuluar që komunikimi ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe organizatave të shoqërisë civile është në “nivel solid të komunikimit, edhe pse jo në nivel të kënaqshëm.”³³ Sipas këtij hulumtimi, rreth gjysma e organizatave të hulumtuara deri në një shkallë janë të kënaqura me nivelin dhe shpeshtësinë e komunikimit me institucionet qendrore, derisa më shumë se një e treta e organizatave të anketuara nuk kanë fare korrespondencë me institucione publike.³⁴ Gjendja është edhe më e dobët për organizatat që veprojnë në veri të Kosovës, kryesisht me komunitetin serb, meqë “përderisa komunikimi me institucionet lokale është më pozitiv, komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror është mjaft sfidues. (...) Këto OSHC ankohen për

mungesën e përgjigjes kur kontaktojnë institucionet qendrore, shpesh duke marrë informata të vonuara me mundësi të kufizuara për ankesë.”³⁵ Ngjashëm me mungesën e komunikimit, organizatat e shoqërisë civile janë të privuara nga mundësia për të ndikuar në vendim-marrje, sidomos në nivelin qendror, përkundër miratimit të Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me Shoqërinë civile 2013-2017,³⁶ si dhe Rregullores për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike.³⁷ Ka pasur çështje të ndryshme që ndikojnë rrjedhen e situatës, si “përbërja etnike, prapavija dhe përvoja në punë me institucionet qeveritare si dhe me rritjen e vetëdijes, që janë shënuar si të rëndësishme në kuptimin e fuqizimit të OShC-ve. Vullneti i institucioneve të nivelit qendror gjithashtu është përmendur si i rëndësishëm.”³⁸

Gjendja e përgjithshme e punëve, me mungesën e komunikimit adekuat dhe të shpeshtë ndërmjet institucioneve publike në njërën anë, si dhe organizatave të shoqërisë civile dhe mediave në tjetrën,

³⁵ Ibid, 85

³⁶ Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, *Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017*, Prishtinë, 2013

³⁷ Rregullorja (GRK) Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik

³⁸ Hoxha Taulant, *Indeksi i Shoqërisë Civile Kosovare (The Kosovar Civil Society Index) 2016*, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Prishtinë, tetor 2016, f. 82

³³ Hoxha Taulant, *Indeksi i Shoqërisë Civile Kosovare (The Kosovar Civil Society Index) 2016*, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Prishtinë, tetor 2016, f. 79

³⁴ Ibid, 84

mungesën e qasjes në dokumente publike që do të mundësonte hulumtimin, kontrollimin e fakteve dhe raportimin, vënë organizatat e shoqërisë civile dhe mediat në pozitë të pafavorshme, ku ata priten të kryejnë një rol të caktuar publik (informimi), por dështojnë në atë drejtim. Situata e tillë njollosë edhe reputacionin e të dy sektorëve, si dhe ndikimet e tyre të ardhme mbi gjendjen socio-politike në Kosovë. Në anën tjetër, këta janë faktorë që kontribuojnë në imazhin negativ të sektorëve si të tërë, për shkak të produkteve joadekuate, apo etikës së punës dhe retorikës publike. Kjo sidomos është e vlefshme tek organizatat e shoqërisë civile, dhe mediat që punojnë me komunitetin serb: “Efektshmëria e shoqërisë civile në pjesën veriore të Kosovës duhet rritur, si dhe pengohet në masë të madhe nga publiku përgjithësisht i painformuar, i keqinformuar apo i paangazhuar, që ka perceptim tejet negativ për shoqërinë civile, konsideruar nga shumë njerëz si sektor “që paguhet nga të gjitha palët”.³⁹ Të gjitha këto krijojnë rreth vicioz të vështirë për ta thyer.

Në anën tjetër, do të ishte e padrejtë si dhe e pasaktë që të anashkalohet puna dhe ndikimi i organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Mediat ende gëzojnë reputacion si kanali kryesor i informatave për Dialogun e Brukselit tek qytetarët, si dhe për më tepër, perceptohen si më të

përgjegjshmet mu për këtë punë.⁴⁰ Perceptimi i shoqërisë civile, në kuptimin e vetëdijesimit të publikut dallon nga ai që media ka,⁴¹ për dy arsye: së pari, vëmendja e tyre ka qenë tek ndihma për mediat që të jenë të njoftuara dhe të njohura, si dhe më vonë, tek bartja e atyre njohurive tek qytetarët, e së dyti, fokusi i tyre në adresim ka qenë më shumë tek institucionet publike dhe bashkësinë ndërkombëtare si vendim-marrës, e jo tek qytetarët. Kjo është arsyeja pse puna e tyre, në masë të madhe, është fokusuar tek të kuptuarit e qytetarët, e jo tek informimi i tyre, si dhe komunikimi i qëndrimeve dhe brengave të tyre me ata që janë përgjegjës për krijimin e të ardhmes më të mirë të Kosovës.

Ky hulumtim ka filluar me një pyetje të thjeshtë – roli dhe angazhimi i shoqërisë civile dhe mediave në Dialogun e Brukselit, si dhe lidhje e këtyre me

⁴⁰ Një hulumtim ka treguar që qytetarët në Kosovë rendisin mediat si pala e tretë më përgjegjëse për informimin e qytetarëve mbi Dialogun e Brukselit: “Kur qytetarët pyeten të rendisin palët të cilat për mendimin e tyre duhet t’i informojnë për Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ata e rreshtojnë Qeverinë si institucioni më përgjegjës për ofrimin e informatave, pastaj parlamentin si të dytin, e pastaj mediat”. Për më shumë, ju lutemi të shihni: Demokratski Insitut Kosova, *Transparentnost Dijaloga Kosova i Srbije: Gledišta gradjana*, Shtator, 2016, f. 6. NB: përkthyer nga serbishtja

⁴¹ I njëjti hulumtim tregon që shoqëria civile vjen në vendin e pestë, nga pesë pozitë, të palëve që janë përgjegjëse për të informuar qytetarët për Dialogun e Brukselit. Ibid.

³⁹ Ibid, 82

vetëdijen e qytetarëve për realitetin politik. Do të ishim naivë sikur të supozonim që nuk ka paragjykime për këtë pyetje, meqë kemi hasur disa herë në ankesa se procesi është jotransparent, se nuk është e përfshirë shoqëria civile, si dhe se mediat nuk janë të informuara. Megjithatë, ajo që shpeshherë ka munguar, së paku në bisedat ditore, ka qenë arsyetimi i atyre përjashtimeve, si dhe pasojave të mundshme. Për këtë arsye, me këtë punim, kemi bërë përpjekje për t'i hulumtuar perceptimet e shoqërisë civile dhe mediave mbi pozitën e tyre aktuale, duke u fokusuar tek “ana tjetër” (pra institucionet publike, përfaqësuesit politikë), qasshmëria dhe gatishmëria e tyre për bashkëpunim dhe ndarje të informatave; por edhe për vetë, rolin dhe përgjegjësi të tyre. Duke e thënë këtë, nuk ka qenë qëllim i joni për të drejtuar gisht, apo për të peshuar përgjegjësinë e secilës palë, por të ndriçojmë gjendjen aktuale, për të avokuar për marrëdhënie më të mira në të ardhmen.

“Kosova dhe Serbia duhet të mendojnë për ndryshimin e mënyrës në të cilën komunikojnë me mediat dhe publikun. Ato duhet të jenë më profesionale në kuptimin e marrëdhënieve publike. E dimë rëndësinë e procesit të dialogut, si dhe të dyja palët duhet të emërojnë zëdhënës për të ardhmen. Gjithashtu, procesi i Dialogut duhet të përfshijë aktorë të tjerë nga

shoqëria civile. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një mjedisi më të shëndoshë të argumentit dhe debatit.”

Intervistë, Burrë, Media

“Kosova duhet të investojë në përforcimin e gazetarisë së pavarur dhe gazetarëve të pavarur, nëse duam të kemi shoqëri të informuar.”

*Intervistë, Grua,
Shoqëri civile*

“Duhet të krijojmë dialog të ri, dialog jo-formal të mediave dhe shoqërisë civile, për të qenë më të qartë dhe analitikë mbi atë që po ndodh në Bruksel dhe Kosovë.”

*Tryezë e rrumbullakët,
Burrë, Media*

LITERATURE

- ACDC, Kontakt Plus, *Posledice odlaganja integracije pravosuđa: Stanje i perspektive*, Mitrovica, Maj, 2015
- BIRN, Big Deal: *Civilized Monotony?, Civic Oversight of the Kosovo – Serbia Agreement Implementation*, Pristina, November 2014
- Qendra për Qeverisje Përfshirëse, *Dialogu i Brukselit: Hapat e ardhshëm dhe sfidat e ardhshme*, nëntor 2015, në dispozicion në: <http://www.cigonline.net/docs/Brussels%20Dialogue%20Next%20Steps%20and%20Challenges%20Ahead.pdf>, qasur së fundi më 16 qershor, 2017
- Demokratski Insitut Kosova, *Transparentnost Dijaloga Kosova i Srbije: Gledišta građana*, shtator, 2016
- Bashkimi Evropian: Komisioni Evropian, *Kosovë* 2016 Raport*, Bruksel, 9 nëntor, 2016, SWD (2016) 363 final
- Garaiova Andrea, *Mbulimi mediatik i Dialogut të Brukselit dhe perspektiva e pajtimit në Kosovë*, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, 2017 (final draft)
- Qeveria e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
- Qeveria e Kosovës: Zyra e Kryeministrit, *Zyra për Qeverisje të Mirë, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017*
- Qeveria e Kosovës: Zyra e Kryeministrit, *Zyra për Qeverisje të Mirë, Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik, aprovuar më 29. 04. 2016.*
- Hoxha Taulant, *Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016*, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Prishtinë, tetor 2016
- IREX, *Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave 2017: Zhvillimi i mediave të qëndrueshme në Evropë dhe Euroazi*, Uashington DC, 2107
- Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, *Zinxhiri i papërfunduar: Dokument politikash për standardet minimale për konsultime publike*, janar 2015
- KoSsev, *Jevtićeva: Srpska na pragu rascepa, veliki deo odgovornosti snosi Kancelarija za KiM*, May 1st, 2017, në dispozicion në: http://kossev.info/strana/arhiva/jevtic_ss/11801, qasur së fundi më 16 qershor, 2017
- Ligji nr. 03/L-215 për qasjen në dokumente publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 88, 25. Nëntor 2010, Prishtinë

- Ligji nr.04/L-057 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14, 9. Shtator 2011, Prishtinë
- Musliu Gresa, *Shteti 30% i qasshëm për qytetarët*, BIRN, Prishtinë, 2013
- Nešović, Branislav, Celeghini, Riccardo, *Bashkësia/Asociacioni i Komunave Serbe: Shuma e të gjitha frikave*, OJQ AKTIV, Mitrovicë, Qershor 2015
- OSBE: Misioni në Kosovë, *Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë*, Prishtinë, qershor 2014
- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (217 [III] A), Paris, 1948
- Vlada Republike Srbije: Kancelarija za Kosovo i Metohiju, *Plan primene sporazuma o normalizaciji odnosa Beograda i Prištine*, në dispozicion në: <http://www.kim.gov.rs/p02.php>, qasur së fundi më 16 qershor, 2017

Përkrahur nga:



unmikonline.org

Implementuar nga::



NEW SOCIAL INITIATIVE

newsocialinitiative.org
facebook.com/newsocialinitiative